



13 - 07 - 2018

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:008931

Datë: 11.06.2018

Numri i dokumentit: 00058402

P.nr.1969/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGGJITSHËM DIVIZIONI PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale me gjyqtarin e vetëm gjykues Ilir Bytyqi si dhe me procesmbajtësen Kadishe Shabani, zyrtare ligjore, në lëndën penale kundër të pandehurit [REDACTED] me vendbanim në Rr. [REDACTED], në Ferizaj, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 nën par.3.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës PP/II nr.1351-3/17 të datës 10.08.2017 në prezencën e Prokurorit të Shtetit Albert Zejnullahu, të dëmtuarve [REDACTED] dhe [REDACTED] si dhe të pandehurit [REDACTED], pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me date 11.05.2018 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 21.05.2018 përpiloi me shkrim këtë:

AKT GJYKIM

I pandehuri: [REDACTED] i lindur me dt. [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe nëna [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], me vendbanim në Rr. [REDACTED], në Ferizaj, ka të kryer shkollën mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, menaxher i kafiterisë [REDACTED], i martuar, prind i tre fëmijëve, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal [REDACTED].

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me dt.11 Prill 2017, rreth orës 22:10, në rrugën “Dëshmorët e Kombit” në Ferizaj, me dashje që t’iu shkakton lëndime trupore i godet me grusht të dëmtuarit - të miturit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], për shkak se të njëjtit disa çaste më herët kishin ndal djalin e të pandehurit [REDAKTUAR], për ta sqaruar një çështje të tyre, me ç’rast të dëmtuarit e lartë cekur pësojnë lëndime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme për shëndetin.

me të cilën kreu veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 nën par. 3.1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata në bazë nenit 188 dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42,49, 51, 64, 65 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurin [REDAKTUAR], e

G J Y K O N

- Dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 /gjashtë/ Muaj, i cili dënim konform nenit 47 me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet me dënim në gjobë në shumën prej 700 Euro /shtatëqind/, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditëve, pasi që aktgjykimi e merr formën e prerë, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.
- Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 46 par. 3 të KPRK-ës, i njëjti do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari do të vuaj dënimin prej 6 Muaj si në piken e parë.
- Të dëmtuarit [REDAKTUAR] me vendbanim në Rr.” [REDAKTUAR]” në Ferizaj dhe [REDAKTUAR] me vendbanim në Rr. [REDAKTUAR], në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.
- Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 30 Euro /tri dhjetë/, shpenzimet e procedurës për ekspertizë mjeko-ligjore shumen

prej 20 Euro /njëzet/ në afat prej 15 ditëve, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

- Obligohet i akuzuari që për kompensimin e Viktimave të Krimit obligohet ta paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë/euro/, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.1351-3/17 të datës 10.08.2017, kundër të akuzuarit [REDAKTUAR] nga Ferizaji, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 nën par.3.1 të KPRK-së.

Gjykata Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 14.02.2018 si dhe shqyrtimin gjyqësor me datë 24.04.2018 dhe datë 11.05.2018, në të cilat faza i akuzuari u deklarua i pafajshëm, për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 nën par.3.1 të KPRK-së.

Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari në shqyrtimin fillestar si dhe në fillim të shqyrtimit gjyqësor nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 nën par.3.1 të KPRK-së.

I njëjti në mbrojtjen e tij ka deklaruar që nuk i kam goditur të dëmtuarit pasi që këta të dy kanë qenë duke u rrahur me dajlin e tij [REDAKTUAR] dhe se ky ka ndërhyrë që ti ndaj, nën supozimin se janë të dëmtuar shpreh keqardhje dhe nuk ka pasur dashje ti lëndoj. Po ashtu është e vërtetë se i kam shkuar tek banesa e [REDAKTUAR] të ti njoftoj prindërit e tyre në lidhje me veprimet e djalit të tyre, pasi që shkaktari kryesor që ka ndodhur rrahja në mes të djemve është [REDAKTUAR] po ashtu deri sa unë isha rrugës për te [REDAKTUAR] kam takuar tek një "Internet Caffë" të dëmtuarin dhe po në këtë vend prapë janë rrahur mes vete [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]. Gjatë rrahjes tek Rr. "Dëshmorët e Kombit", respektivisht tek shkolla "Jeronim Derada" rreth orës 22:00h, kanë qenë rreth dhjetë persona të gjeneratës së djalit tim dhe të dëmtuarve,

unë aty e kam një lokal ku punoj dhe veproj dhe e kam parë rrahjen se si ka ndodhur dhe kam shkuar që të intervenoj respektivisht që ti ndaj, nuk qëndron e vërtetë se unë ju kam thënë të dëmtuarve që në polici të deklarojnë se unë nuk i kam goditur, por unë në atë takim kam provuar ti ofroj fëmijët në mes veti pasi që këta kanë qenë shokë. [REDAKTUAR] është goditur edhe nga policët këtë vetë e ka pohuar edhe në gjykatë dhe për mua lind dilema se kush i ka shkaktuar lëndime trupore.

Me tutje i pandehuri [REDAKTUAR] mbrojtjen e tij e orienton në atë se, djalin tim e kam vërejtur se që është e përfshirë në rrahje pasi ka dëgjuar zërin e tij, distanca mes vendit të ngjarjes dhe mua ishte rreth 10-15 metra, në mesin e atyre personave ishin edhe këta të dëmtuarit në sall, unë fillimisht e kanë kapur djalin tim edhe përkundër kësaj ata prapë vazhdojshin duke u rrafur, nuk e dinë nëse e ka kapur [REDAKTUAR] apo [REDAKTUAR] mirëpo e kam shtyr herë njërin – herë tjetrin, jam munduar me fjalë ti largoj por nuk dëgjonin as njëri. Ndërsa rrugës për ke banesa e [REDAKTUAR] (i pandehuri me vete dhunshëm kishte marr edhe të dëmtuarin [REDAKTUAR] për t'ia tregu shtëpinë), gjatë kësaj rruge te internet kafe kanë takuar përsëri [REDAKTUAR], deri sa djali im [REDAKTUAR] ka tentuar të rrafet me [REDAKTUAR] unë kam ndërhy ti ndal, respektivisht as un nuk e goditur fare [REDAKTUAR] as me duar as me cigare.

Vlesimi i mbrojtjes të të pandehurit

Gjykata hodhi poshtë pretendimin e të pandehurit se nuk e ka kryer veprën penale me te cilën është ngarkuar pasi që nga provat e paraqitura ekzistojnë elementet e kësaj vepre penale.

Gjykata çmoj dhe vlerësoj mbrojtjen e të pandehurit [REDAKTUAR] se kinse nuk i ka sulmuar dhe as goditur në asnjë mënyrë të dëmtuarit pasi që këta të dy kanë qenë duke u rrahur me dajlin e tij [REDAKTUAR] dhe ai ka hyrë që ti ndaj, por një mbrojtje të tillë gjykata nuk e aprovoj, nga fakti si nga ekspertiza mjeko-ligjore e dt.06.08.2017, u dëshmuar se të dëmtuarit kanë pësuar lëndime të lehta trupore, po ashtu edhe nga dëshmia e të dëmtuarve u vërtetua pa mëdyshje dhe në mënyrë të sigurt se i pandehuri i ka sulmuar të dëmtuarit duke e goditur me grushte dhe shuplaka në fytyrë.

I dëmtuari [REDAKTUAR] gjatë shqyrtimit gjyqësor ka vërtetuar se kam edhe një deklaratë në polici dhe qëndroj pranë saj, më tutje vërteton se ka qenë me disa shokë: [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] te shkolla "Jeronim Derada", më pas aty jemi takuar me djalin e [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] e kemi pyetur se ku është [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] na ka

pyetur se çka po ju vyn, ne i kemi treguar se kemi punë me atë sepse i njeti na ka fyer, pastaj [REDAKTUAR] na ka thënë pritni vetëm pak, ne kemi pritur rreth 2-3 min, pastaj kanë ardhur [REDAKTUAR] me prindin e tij, në atë moment menjëherë [REDAKTUAR] ka filluar ta sulmojë [REDAKTUAR] më grushte në pjesë të ndryshme të trupit, unë kam provuar ti ndaj në atë moment ka ardhur prindi i [REDAKTUAR] dhe më është drejtuar me fjale pse je duke ma rrahur djalin, dhe pastaj ka filluar edhe prindi i [REDAKTUAR] të më godas me grushta në kokë, pastaj një shok i imi me emrin [REDAKTUAR] ka dashur që të ndaj me prindin e [REDAKTUAR] mirëpo nuk ka mundur dhe i njëjti e ka shtyrë babën e [REDAKTUAR] dhe ka ikur nga vendi i ngjarjes, më pas prindi i [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] prapë ka filluar të më godas në kokë me grushte dhe më ka kapur për jakne dhe më ka thënë ta dërgoj tekë banesa e [REDAKTUAR], unë nuk kam pranuar ti tregoj ndërsa [REDAKTUAR] vazhdimisht më godiste, pasi më ka goditur mjaft më ka liruar dhe unë kam ecur në drejtim të rrugës mbrapa "Vivës" së vjetër, në këtë rrugë duke ecur për në shtëpi sapo kam arritur tek lokali "Metro-Internet", e kam parë përsëri [REDAKTUAR] duke e rrahur [REDAKTUAR] aty më ka parë [REDAKTUAR] me prindin e tij dhe përsëri më kanë sulmuar [REDAKTUAR] dhe djali i tij [REDAKTUAR] dhe më kanë kërkuar që ti dërgoj tekë banesa e [REDAKTUAR] unë e pash që vazhdimisht më godiste u frikësova dhe i dërgova tek banesa e [REDAKTUAR], i kam dërguar aty në banesë ka qenë vetëm nëna e [REDAKTUAR] si dhe motrat dhe [REDAKTUAR] e ka kërcënuar nënën e [REDAKTUAR] se do ta vras djalin, ndërsa [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] janë larguar nga banesa e [REDAKTUAR], nëna e [REDAKTUAR] me emrin [REDAKTUAR] e njëjta e ka thirrur policinë.

I dëmtuari [REDAKTUAR], gjatë shqyrtimit gjyqësor ka vërtetuar se: ka edhe një deklaratë në polici dhe qëndroj pranë saj, ngjarja ka ndodhur më 11.04.2017 rreth orës 22:00h, unë kam qenë me shokët e mi [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] si dhe djali i tezes sime [REDAKTUAR], me [REDAKTUAR] jemi takuar tekë shkolla "Jeronim Derada" dhe ky i fundit na thotë ajeni ju burra, ne nuk donim të ngucemi dhe i kërkuam që të vazhdoj rrugën, pas 5 min, ka ardhur me prindin e tij me emrin [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] fillimisht më ka sulmuar në fytyrë 4-5 herë dhe unë jam rrëzuar në tokë, kur jam ngritur në këmbë e kam parë prindin e [REDAKTUAR] duke e goditur [REDAKTUAR] pastaj unë kam ikur me dajlin e tezes dhe kam shkuar në lokalin "Metro", aty pas 30 minutash ka ardhur [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] unë isha i ulur në karrige dhe të njëjtit kanë filluar të më sulmojnë me grushte dhe shuplaka në fytyrë, kurse [REDAKTUAR] edhe me cigare më ka djegur në mes të hundës dhe buzës e gjitha kjo ka ndodhur në lokal brenda, pastaj [REDAKTUAR] me prindin e tij ka ndalur dhe së bashku me personin [REDAKTUAR] kanë filluar ta sulmojnë [REDAKTUAR] edhe unë nga ai moment kam shkuar tekë shtëpia e tezakut tim dhe më pas kemi shkuar në polici.

Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Pasi që i akuzuari, nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 nën par.3.1 të KPRK-së .Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njërën me tjetrën, në kuptim të dispozitës së nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPPK-ës, vërtetoj gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi:

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- Nga dëshmia e dëshmitarëve – të dëmtuarve [REDACTED] dhe [REDACTED];
- Nga përmbajtja e raporti të oficeri 2017-CF-766;
- Ekspertiza mjeko-ligjore e dt.06.08.2017;
- Pjesërisht nga mbrojtja e të pandehurit [REDACTED]

Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Fillimisht Gjykata vlerëson si të pakontestueshme dhe të provuara faktet dhe rrethanat e mëposhtme:

Me dt.11 prill 2017, rreth orës 22:10, në rrugën “Dëshmorët e Kombit” në Ferizaj, me dashje që t’iu shkakton lëndime trupore godet me grusht të dëmtuarit- të miturit [REDACTED] dhe [REDACTED], për shkak se të njëjtit disa çaste më herët kishin ndal djalin e të pandehurit [REDACTED], për ta sqaruar një çështje të tyre, me ç’rast të dëmtuarit e lartë cekur pësojnë lëndime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Gjykata gjendjen faktike e vërtetoi duke u bazuar nga dëshmia e dëshmitarëve - te dëmtuarve [REDACTED] dhe [REDACTED], si dhe si dhe nga provat tjera qe gjenden ne shkresat e lendes siç është: raporti oficerit 2017-CF-766 i dt.11.04.2017 dhe Ekspertiza mjeko-ligjore e dt.06.08.2017.

Akt ekspertimi mjeko-ligjor i dt. 06.08.2017, vërteton se të dëmtuarit [REDACTED] ka pësuar ndrydhje të indeve të buta përreth syrit të djathtë të fytyrës, hundës, gërrvishje dhe

dërrmishje lëkurore të qafës, ndërsa për të dëmtuarin [REDAKTUAR] ka pësuar gërvishje dhe dërrmishje në regjionin e qafës së djathtë të fytyrës dhe laperes së veshit të djathtë, me besueshmëri të shkaktuara nga mjeti veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo i mprehtë dhe i topitur), si të tilla një nga një dhe së bashku bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore me dëme të përkohshme të shëndetit, nëse i referohemi mjetit të topitur edhe forma e grushtit e plotëson standartin e të provuarit.

Vlerësimi ligjor i veprimeve të akuzuarit

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 nën par 3.1 të KPRK-së për te pandehurin [REDAKTUAR] të kryer në mënyrën dhe rrethanat e përshkruara si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

Nga interpretimi i dispozitës të nenin 188 arrihet në përfundimin se: ligjvënësi ka parashikuar një mbrojtje të posaçme juridike në drejtim të mbrojtjes së jetës dhe integritetit fizik, të personit, cenimi i të cilit pas sjell përgjegjësi penale. Këto veprime, për t'u cilësuar si vepër penale nga ligji, duhet që të kenë prekur shëndetin e personit, konkretisht funksionimin normal të trupit të të dëmtuarit, duke i sjelle atij paaftësi të përkohshme. Pos kësaj kjo vepër penale merr në mbrojtje jetën dhe trupin e njeriut. Në rastin konkret veprimet e lëndimit të lehtë trupor duhet të sjellin si pasojë cenimin e integritetit fizik, psikosocial e ekonomik, rrethanë kjo cilësuese e veprës penale.

Fjala përfundimtare e paleve

Prokurori i Shtetit gjatë shqyrtimi gjyqësor si dhe në fjalën përfundimtare të tij deklaroi: mbetem në tërësi pranë aktit akuzues dhe rikualifikim juridik, gjatë këtyre shqyrtimeve gjyqësore vërtetohet se i pandehuri është kryes i kësaj vepre penale e kjo vërtetohet nga dëshmia e dëshmitarëve – të dëmtuarve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]. Këtu nuk është fare kontestues se natën kritike ka ndodhur një rrahje e këtë e deklaroi edhe vet i pandehuri, nga dëshmia e dëshmitarit [REDAKTUAR] vërtetohet fakti se fillimisht kanë pasur një mosmarrëveshje me [REDAKTUAR] djalin e të pandehurit dhe gjatë konfliktit verbal që kanë pasur në atë moment vjen edhe i pandehuri i cili e godet me grushte në kokë, të njëjtën gjë e dëshmon edhe dëshmitari – i dëmtuari [REDAKTUAR] se të njëjtin i ka goditur na vërteton edhe prova materiale ekspertiza mjeko-ligjore dt.06.08.2017, ku janë të përshkruar lëndimet e lehta trupore, nuk duhet falur besimin mbrojtjes së të pandehurit i cili nuk e pranon se është kryesi i

kësaj veprë penale me arsytim se ka qenë duke i ndarë, por dëshmia e dy të dëmtuarve është shumë e përafërt në përshkrimet e veprimeve të të pandehurit. Gjykata duhet ta ketë parasysh faktin se të dëmtuarit kanë qenë të mitur andaj edhe është dashur të jetë edhe më i kujdesshëm, andaj bazuar në të gjitha këto kërkojmë nga gjykata që të njëjtin ta shpall fajtor konform ligjit.

I dëmtuari [REDAKTUAR] në fjalën përfundimtare të tij ka mbështet në tërësi prokurorin e shtetit në këtë çështje penale si dhe i bashkangjitet ndjekjes penale ndërsa për kërkesën pasurore – juridike do të paraqet ne procedurë kontestimore.

I dëmtuari [REDAKTUAR] në fjalën përfundimtare të tij ka mbështet në tërësi prokurorin e shtetit në këtë çështje penale si dhe i bashkangjitet ndjekjes penale ndërsa për kërkesën pasurore – juridike do të paraqet ne procedurë kontestimore

I pandehuri [REDAKTUAR] në fjalën përfundimtare të tij deklaroi: unë dua të theksoj publikisht dhe dua t'iu kërkoj falje publike të dëmtuarve nëse ju kam shkaktuar ndonjë lëndim, mirëpo jo me dashje pasi që këta janë edhe shokë të djalit tim dhe për nga mosha mua nuk më lejon ndërgjegjja ti godas, po ashtu i propozoj gjykatës që të më liroj nga akuza.

Vlerësimi lidhur me dënimin e shqiptuar

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të neni 73 dhe 74 të KPRK-së, ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjykata të akuzuarit si rrethanë lehtësuese i mori parasysh sjelljen e tij korrekte dhe kërkim faljen publike, nuk ka dëshmi se është i dënuar me aktvendim të formës së prerë, ndërsa në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese gjykata vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale për të pandehurin dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale si dhe faktin se lëndimi i lehtë trupor iu është drejtuar dy të miturve, mbi baze të këtyre rrethanave i shqiptoj dënimin si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata është e bindur se me anë të këtij dënimi është e pritshme të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPK-ës, dhe me këtë dënim që është në proporcion me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, rrethanat dhe mënyrën e kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit, se me anë të këtij dënimi do të arrihet qëllimi i dënimit, parandalimi i kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe njëkohësisht do të arrihet edhe qëllimi tjetër që ti përmbaj personat

e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale), se përmes këtij dënimi do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Kërkesa pasurore juridike dhe shpenzimet procedurale

Të dëmtuarit [REDAKTUAR] nga Ferizaj, Rr. [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] nga Ferizaj Rr. [REDAKTUAR], për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontestin civil.

Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-ës obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 € në afat prej 15 ditëve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit


Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.1969/17 dt. 21.05.2018

Zyrtare ligjore
Kadishe Shabani

Gjyqtari: Ilir BYTYQI



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.